



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJET E BASHKUARA**

Nr. 61004-00045-00-2016 i Regj. Themeltar

Nr. 00-2022- i Vendimit

VENDIM I NDËRMJETËM

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga gjyqtarët:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Illir PANDA	Anëtar
Albana BOKSI	Anëtare
Medi BICI	Anëtar
Sokol BINAJ	Anëtar
Sandër SIMONI	Anëtar
Artur KALAJA	Anëtar
Ervin PUPE	Anëtar
Asim VOKSHI	Anëtar
Arbena AHMETI	Anëtare
Gentian MEDJA	Anëtar
Sokol NGRESI	Anëtar
Dariel SINA	Anëtar
Margarita BUHALI	Anëtare
Enton DHIMITRI	Anëtar

në datë 04.10.2022, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

KUNDËR: Personit nën hetim Ervin Cara

I DYSHUAR: Për kryerjen e veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga nenet 259/2 e 25 të Kodit Penal

OBJEKTI: Vleftësim i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktim mase sigurimi “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale

BAZA LIGJORE: Nenet 228, 229, 230, 238, 244 të Kodit të Procedurës Penale

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ilir Panda dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N,

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale "Përshtatja e lokalit për përdorim droge", të parashikuar nga neni 285/a i Kodit Penal në ngarkim të të dyshuarit, shtetasit Ervin Cara. Sipas akteve të paraqitura, rezulton se nga ana e forcave të policisë, në datën 5.10.2015, është ushtruar kontroll në ambientet e lokalit të natës "Moscoë Club", i ndodhur në rrugën "5 Maji", Tiranë, pasi dyshohej se në ambientet e brendshme të këtij lokali shpërndahej dhe konsumohej lëndë narkotike. Pas kontrollit të ushtruar në ambientet e brendshme të lokalit është konstatuar se në një nga dhomat e lokalit që shërbente për personelin është gjetur dhe sekuestruar një sasi lënde e cila ka rezultuar me peshë 1.8 gram dhe dyshohej se ishte lëndë narkotike e llojit kokainë. Po kështu, në tualetin e lokalit janë gjetur dy pjata në sipërfaqen e të cilave dyshohej se kishte mbetje të lëndës narkotike e dyshuar e llojit kokainë dhe se këto pjata përdorshin për konsumim lënde narkotike.

2. Ndodhur në këto kushte, Oficerët e Policisë Gjyqësore Tiranë kanë bërë arrestimin në flagrancë të personit nën hetim Ervin Cara, në cilësinë e njërit nga bashkëpronarët e lokalit ku dyshohet se është konsumuar vepra penale e parashikuar nga neni 285/a i Kodit Penal si dhe kanë kryer veprime të tjera procedurale. Nisur nga rrezikshmëria e veprës penale dhe e personit organi i prokurorisë ka kërkuar vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi personal "Arrest në burg me afat 40 ditë" të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

3. Personi nën hetim dhe mbrojtësi i tij u shprehën se arrestimi në flagrancë duhet të vlerësohej si i paligjshëm dhe të urdhërohej lirimi i menjëhershëm i të dyshuarit pasi nga ana e tij nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën dyshohet se ka kryer pasi në lokalit që pretendohet se ka ndodhur ngjarja nuk ka asnjë ambient publik apo privat të përshtatur me qëllim për të konsumuar lëndë narkotike.

4. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3853 akti, datë 27.10.2015, ka vendosur: "Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim Ervin Cara.**

Caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg me afat 20 ditë", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale për personin nën hetim Ervin Cara."

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, ka arsyetuar se kushtet ligjore për vleftësimin e arrestit janë të parashikuara nga nenet 251 dhe 252 të K.Pr.Penale. Sipas këtyre dispozitave arrestimi në flagrancë kryhet për një krim me dashje të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet ose që kapet në flagrancë për një krim të kryer me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër të kryer nga pakujdesia për të cilin ligji cakton dënim me burgim jo më të ulët në maksimum se tetë vjet.

6. **Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim personi nën hetim Ervin Cara** me të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore”.

7. Në gjykimin në apel, përfaqësuesi i prokurorisë në konkluzionet përfundimtare parashtroi se kërkonte ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore”.

8. **Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1662, datë 13.11.2015**, ka vendosur: *“Miratimin e vendimit nr. 3853 akti, datë 27.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”*

9. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se vihet në dukje se gjatë gjykimit përfaqësuesi i Prokurorisë së Apelit Tiranë (mbasi dëgjoi mbrojtësin e personit nën hetim), në konkluzionet e tij me shkrim deklaroi shprehimisht si vijon: "Kemi mendimin se masa e sigurimit duhet të ndryshohet dhe ndaj personit nën hetim duhet të caktohet "detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale. Gjykata e Apelit Tiranë, analizon dhe çmon se mendimi sa më sipër i përfaqësuesit të organit të prokurorisë së Apelit Tiranë, është i pamotivuar dhe i papranueshëm.

10. Duke i'u referuar rastit në fjalë, nisur nga studimi i praktikës gjyqësore që lidhet me institutin e masave të sigurimit, Gjykata e Apelit Tirane çmon të ndryshojë qëndrimin e mbajtur në disa raste të mëparshme rreth parashtimit të organit të akuzës në shkallë të dytë për një masë sigurimi më të butë nga sa është kërkuar në kërkesën e paraqitur me caktimin e masës së sigurimit në shkallë të parë. Konkretisht, bëhet fjalë për rastet kur organi i prokurorisë ka kërkuar në shkallë të parë për një individ të caktuar - person nën hetim, caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg" me afat 40 ditë, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Në shkallë të dytë, prokurori, në kundërshtim me kërkesën e bërë në shkallë të parë për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg" me afat 40 ditë, parashton qëndrimin për një masë sigurimi më të butë, ndonëse nuk e ka kundërshtuar (nuk ka bërë apelim) vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

11. Në praktikën e mëparshme, Gjykata e Apelit ka pasur raste dhe ka pranuar qëndrim të prokurorit në shkallë të dytë, duke e motivuar me kërkesat e nenit 244/3, të K.Pr.Penale. Pavarësisht kësaj praktike të ndjekur, Gjykata e Apelit Tiranë, nisur nga rasti objekt gjykimi që i përket personit nën hetim Ervin Cara, si dhe duke analizuar praktikën gjyqësore në raport me kërkesat e ligjit, arrin dhe përfundimin se praktika e mëparshme ka vend të ndryshohet dhe parashtimi i prokurorit në shkallë të dytë të mos pranohet për shkaqet e mëposhtme:

12. Së pari: Nga aktet në dosje konstatohet se ankim për këtë çështje është bërë vetëm nga personi nën hetim Ervin Cara, por jo nga Organi Prokurorisë, gjë që do të thotë gjykimi në Apel zhvillohet vetëm mbi këtë ankim (me hollësisht shih nenet 407 deri 430 të K.Pr.Penale).

13. Së dyti. Gjykata e Apelit Tiranë vlerëson e çmon se në një rast të tillë kur gjykimi në Apel zhvillohet vetëm mbi bazën e ankimit të bërë nga personi nën hetim - mendimi me shkrim i shfaqur nga prokurori i Apelit gjatë gjykimit për zbutjen e masës së sigurimit (sikurse ka kërkuar me ankimin e tij personi nën hetim) në këndvështrimin ligjor procedural nuk mund të ketë fuqi detyruese për trupin gjykues qoftë edhe në këndvështrimin e nenit 244/3 të K.Pr.Penale. Kjo sepse:

a) Organi i Prokurorisë nuk ka ushtruar apelim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sa më sipër, do të thotë se është pajtuar dhe se për prokurorin ai vendim ka marrë formë të prerë;

b) Mendimi me shkrim i Prokurorit të Apelit i paraqitur gjatë gjykimit, në përmbajtjen e tij nuk mund të njësohet me "mjetin juridik" të ankimit të Prokurorit të Apelit që parashikohet në K.Pr.Penale;

c) Siç dihet, shqyrtimi në shkallë të dytë bëhet në kuadër të kërkesës së prokurorit për caktim mase sigurimi mbi të cilën është dhënë vendim nga gjykata e shkallës së parë dhe ndaj të cilit është ushtruar ankim nga personi nën hetim. Në fillim të shqyrtimit në shkallë të dytë, nuk rezulton që prokurori të ketë paraqitur kërkesë paraprake për heqje apo ndryshim të masës së sigurimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë, në mënyrë që gjykata e apelit të investohej mbi këtë kërkesë. Përkundrazi, prokurori i apelit e ka pranuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe mbasi është dëgjuar ankimi i personit nën hetim, thjeshtë ka shfaqur mendimin e tij për një masë sigurimi më të butë nga sa është caktuar nga gjykata e shkallës së parë. Për rrjedhojë ky qëndrim i prokurorit në apel, kurrsesi nuk mund të njësohet me "kërkesë për ndryshim të masës së sigurimit".

d) Edhe nëse do të pranohej e kundërta, shtrohet pyetja se çdo të bëhej me gjykimin në Apel, nëse personi nën hetim do të hiqte dorë nga ankimi i tij mbi bazën e të cilit është nisur ai gjykim. Është e kuptueshme se në një rast të tillë në përputhje me kërkesat e nenit 420/1/ç të K.Pr.Penale do të vendosej mospranimi i ankimit gjykimi në Apel do të mbyllej dhe nuk mund të vazhdonte mbi "mendimin me shkrim të shfaqur nga Prokurori i Apelit në lidhje me masën e sigurimit të kërkuar nga personi nën hetim me ankimin e tij. Pra siç shihet, ky mendim me shkrim i Prokurorit të Apelit në një situatë të tillë nuk mund të ketë fuqi detyruese.

e) Edhe në qoftë se do të pranohet që mendimi me shkrim i Prokurorit të Apelit në situatën e sipërcituar do të përbënte një "formë ankimi" -ky ankimi rezulton që të jetë jashtë afatit 10 ditor që parashikon ligji procedural penal, gjë që do të thotë se ai në vështrim të nenit 420/1/ç të K.Pr.Penale nuk mund të ketë fuqi detyruese qoftë edhe në vështrim të nenit 244/3 të K.Pr.Penale.

14. Kundër vendimi të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë me të cilin ka kërkuar: *Prishjen e vendimit nr. 1662, datë 13.11.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë për caktimin e masës së sigurimit personal për personin nën hetim nga "arrest ne burg" të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale në atë të "Detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" çdo ditë të premte, ora 14:00, të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.*

15. Në rekurs, prokuroria ka pretenduar, ndër të tjera, këto shkaqe:

- Vendimi i gjykatës së apelit që nuk ka pranuar kërkesën e prokurorit të seancës është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal.
- Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë nga ajo e kërkuar nga prokurori.
- Në të tilla rrethana arrihet në konkluzion se vendimi i Gjykatës së Apelit nr. 1662 date 13.11.2015, kur nuk ka pranuar kërkesën e Prokurorit të seancës, është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal. Vlen të theksohet fakti se një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe Gjykata e Lartë në vendimin nr. 536 date 30.09.2002 ku në përbërje të trupit gjykues ka qenë një anëtar i trupit gjykues në atë kohë (anëtar i Gjykatës së Lartë) dhe sot po ky anëtar i trupit gjykues, mban qëndrim ndryshe nga ai i Gjykatës së Lartë.

16. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin datë 09.03.2016 ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore për t'u shqyrtuar në Kolegjet e Bashkuara.

II. Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

17. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se ndaj vendimit nr. 1662, datë 13.11.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin datë 09.03.2016, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore për t'u shqyrtuar në Kolegjet e Bashkuara.

18. Fillimisht Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të ndalen në kompozimin e trupit gjykues për gjykimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, për shkak se nga momenti i marrjes së vendimit nr. s'ka, datë 09.03.2016, të Kolegjit Penal për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore për unifikim të praktikës gjyqësore dhe deri në momentin e shqyrtimit të çështjes, për shkak të plotësimit të numrit të gjyqtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka kaluar një kohë e konsiderueshme. Ky faktor reflekton, ndër të tjera, ndryshime thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur çështja është regjistruar pranë Gjykatës së Lartë dhe është marrë vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore deri në momentin e shqyrtimit të çështjes objekt gjykimi.

19. Një nga ndryshimet që ka sjellë ligji nr. 44/2021 është procedura e gjykimin për ndryshimin ose njësimin e praktikës gjyqësore. Para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, paragrafi i dytë i pandryshuar i nenit 141 të Kushtetutës parashikonte se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të caktuara gjyqësore.”* Nga kjo normë kushtetuese kuptohej se unifikimin e praktikës gjyqësore dhe ndryshimin e saj kishte autoritet ta bënte vetëm trupa gjyqësore e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, qoftë për krijimin e precedentëve fillestar ashtu edhe për ndryshimin apo zhvillimin e tyre në të ardhmen. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, amendime të cilat hynë në fuqi në datë 11.08.2016, neni 141 i Kushtetutës parashikon se: *“1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. 2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.”*

20. Kjo do të thotë se, ndryshe nga më parë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk unifikojnë apo njësojnë praktikën gjyqësore nëpërmjet krijimit të precedentëve fillestar jurisprudencial ose, thënë ndryshe, nuk njësojnë qëndrimet e ndryshme mbi zbatimin e ligjit procedural dhe material nga gjykatat më të ulëta. Këtë funksion të nomofilatisë apo uniformitetit të praktikës gjyqësore e bën vetëm Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për çështjet civile, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për çështjet administrative dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për çështjet penale. Këtë funksion kushtetues dhe ligjor secili prej kolegjeve do ta realizojë nëpërmjet vendimeve njësuere, të cilat kanë zëvendësuar terminologjinë dhe praktikën e mëparshme të vendimeve unifikuese. *(shih vendimin njësuues nr. 13, datë 04.04.2018, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*

21. Për të konkretizuar dhe zbatuar në ligj parashikimet e reja të nenit 141 të Kushtetutës, ligji nr. 98/2016, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, në nenin 32 normoi rastet e kompetencës funksionale të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke parashikuar se: *“1. Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara për çështje civile, penale ose administrative, të cilat, me vendim të një prej trupave gjykues ose të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, paraqiten për shqyrtim për ndryshimin e praktikës gjyqësore.”*

2. Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë rastet kur e njëjta çështje juridike nuk është interpretuar në mënyrë të njëjtë nga kolegje të ndryshme të Gjykatës së Lartë, ose në rast se ekziston rreziku për interpretim jo të njëjtë nga kolegje të ndryshme të Gjykatës së Lartë.”.

22. Ndryshimet e ligjeve procedurale gjyqësore në vitin 2017 plotësuan dhe detajuan kuadrin ligjor të nevojshëm për të ushtruar Gjykata e Lartë juridiksionin ekskluzivisht ligjor dhe rishikues dhe njëkohësisht edhe nomofilatik sikurse ndryshimet kushtetuese konturuan. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, neni 438 i Kodit të Procedurës Penale, që rregullon gjykimin në Kolegje të Bashkuara, nuk pësoi ndryshime me ligjin nr. 35/2017. Kjo dispozitë ndryshoi vetëm me ligjin nr. 41/2021, ligj që ka bërë një rregullim të qartë të kompetencës së Gjykatës së Lartë për njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore.

23. Neni 483/3 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Penal me trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, në të cilën marrin pjesë trupa gjyqësore që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të kolegjit të caktuar me short.”. Ndërsa neni 438/4 i KPP parashikon se Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë çështje për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Ndryshimet ligjore procedurale sa më sipër imponojnë ndryshimin e procedurës së gjykimit pranë Gjykatës së Lartë por nuk diktojnë kompetencën funksionale të saj për marrjen në shqyrtim të mosmarrëveshjes.

24. Në këto kushte, duke qenë se Kolegji Penal ka vendosur unifikimin e praktikës gjyqësore, ose, me terminologjinë e aktuale, njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se kjo çështje duhet të shqyrtohet nga Kolegji Penal në seancë gjyqësore me trup të përbërë nga 5 gjyqtarë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 438 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 38 të ligjit nr. 41/2021, datë 23.03.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N

Çështja nr. 61004-00045-2016, datë 31.01.2016, të kalojë për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë për të vijuar procedurën e njësimin të praktikës gjyqësore.

Tiranë, më 04.10.2022